



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____prot.

Durrës, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

[01.11.2023]

Drejtuar: K.M.K me NIPT NIPT L78223801E + CAUSHI M me NIPT L88419801O *me adresë*: Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur Punë

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-57364-01-30-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikualifikim hapësira publike në Lagjen nr.13 dhe nr.6”

Fondi limit: 21’144’868 (njëzetë e një milion e njëqind e dyzetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh

kohëzgjatja e kontratës: 56 (ditë)

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike [06.02.2023] [NR.12]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. NIKA me NIPT J76705047U me vlerë të ofertës 14’167’315.21 (katërbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë presje njëzetë e një) lekë
2. “M U R A T I” me NIPT J66702413V + EURO-ALB me NIPT K66613407H me vlerë të ofertës 15’436’232.00 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë

3. T&XH me NIPT L72121504I me vlerë të ofertës 15'463'476.75 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e pesë) lekë
4. K.M.K me NIPT NIPT L78223801E + CAUSHI M me NIPT L88419801O me vlerë të ofertës 15'633'895.00 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë
5. NDERTUESI 2000 me NIPT J96409033R me vlerë të ofertës 16'166'368.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë
6. I.C.C GROUP me NIPT L51308006A + MF INVEST GROUP me NIPT L71830010R me vlerë të ofertës 16'276'777.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë
7. EURONDERTIMI 2000 me NIPT K02003001O me vlerë të ofertës 16'294'277.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë
8. ASI-2A CO me NIPT K53002402C me vlerë të ofertës 16'443'469.90 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e dyzetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë) lekë
9. 2 N me NIPT L31615017L me vlerë të ofertës 16'579'659.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë
10. LIQENI VII me NIPT K01730502W me vlerë të ofertës 17'146'605.00 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë
11. RSM COMPANY me NIPT L04803001U me vlerë të ofertës 17'148'562.00 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë
12. BEQIRI me NIPT J98624801V me vlerë të ofertës 17'685'709.70 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntë presje shtatëdhjetë) lekë
13. S I R E T A 2F me NIPT K51501008J me vlerë të ofertës 17'777'777.00 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë
14. KTHELLA me NIPT J69303023D me vlerë të ofertës 17'872'285.00 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë
15. GLAVENICA me NIPT K17710805E me vlerë të ofertës 17'977'330.00 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë) lekë
16. ZEQILLARI me NIPT L61912024O me vlerë të ofertës 18'265'741.82 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzetë e një presje tetëdhjetë e dy) lekë

17. XHAST me NIPT K12512837I me vlerë të ofertës 18'740'576.25 (tetëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë presje njëzetë e pesë) lekë
18. KEVIN KONSTRUKSION me NIPT K71401004W me vlerë të ofertës 19'024'013.74 (nëntëmbëdhjetë milion e njëzetë e katër mijë e trembëdhjetë presje shtatëdhjetë e katër) lekë
19. SARK me NIPT K52531415H me vlerë të ofertës 19'549'352.00 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 - Për ofertuesin NIKA me NIPT J76705047U, me vlerë të ofertës 14'167'315.21 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **NIKA**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në procedurën me objekt "Rikonstruksion shkollë "Dom Nikoll Kaçorri", në të cilën është shpallur fitues.

2- Për ofertuesin "M U R A T I" me NIPT J66702413V + EURO-ALB me NIPT K66613407H, me vlerë të ofertës 15'436'232.00 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **"M U R A T I" + EURO-ALB**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik EURO-ALB janë të angazhuar në kontratën me objekt "Loti III Riforcim godine banimi 12-13 kat mbi tokë dhe një kat nëntokë, Rr.Jahja Ballhysa nr.6, gis 3092 (Jedasi)".

2. Nuk përmbush piken 2.3.f të Kapacitetit Teknik, pasi bashkimi i operatoreve "M U R A T I" + EURO-ALB nuk ka vetedeklaruar automjetet veshkarkues me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton.

3- Për ofertuesin T&XH me NIPT L72121504I, me vlerë të ofertës 15'463'476.75 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për permbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **T&XH**:

1. Nuk përmbush piken 2.2.a të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku citohet "Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore", pasi referuar ekstraktit historik, me datë 26.05.2022, me numer ceshtje CN-909675-05-22, është shtuar

adresa dytesore: “Tirane; KAVAJE; Qerret; Pasuria Nr 1/423 dhe Zona Kadastrale 3101, Kavaje”, e cila është mbyllur me date 15.11.2022, me numer ceshtje CN-030810-11-22.

Persa me lart, referuar dokumentacionit të paraqitur me date 07.08.2023, nuk është paraqitur dokument për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022 nga Bashkia Kavaje.

2. Nuk përmbush piken 2.3.e të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Manovratorë 2 punonjes; Drejtues Mjeti 3 punonjes; Hekurkthyes 2 punonjes; Karpentiere 2 punonjes; Punëtore ndertimi të thjeshtë 20 punonjes. Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune”.*

Referuar dokumentacionit të paraqitur me date 07.08.2023, për 1 hekurkthyes (XH.S) si dhe për 2 karpentiere (K.ZH, S.M) nuk është paraqitur dokumentacion që vërteton profesionin (dëshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj), por vetëm IQT dhe kontrata e punës. Dokumenti dëshmi për kualifikimin e sigurimit teknik/certifikatë mbi sigurimin teknik të paraqitura, ka për qëllim sigurimin teknik të punonjësve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre në përputhje me ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001, “Për Garantimin e Sigurisë së Punës të Pajisjeve dhe Të Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, por nuk zëvendëson në asnjë rast dëshminë profesionale, e cila është kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit për të gjithë punonjësit.

Ky qëndrim është i bazuar edhe në vendime të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik, siç mund të përmendim Vendimin nr. 238/2021, datë 25.05.2021, përkatesisht paragrafi III.1.7 i tij.

Gjithashtu, për punonjësit e vetedeklaruar si drejtues mjeti (L.C, F.T) janë paraqitur dëshmitë e aftësisë profesionale për kategorinë eskavatorist (manovrator), dhe jo dokumenti leje drejtimi për kategoritë e mjeteve të kërkuara, në përmbushje të kriterit drejtues mjeti.

3. Nuk përmbush piken 2.3.f të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton – 1 cope; Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton – 1 cope; Automjete vetshkarkuese me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton – 1 cope; Autobetoniere – 1 cope; Graider – 1 cope; Eskavator me goma – 1 cope; Asfaltshtruese me krah – 1 cope; Autobot Uje – 1 cope; Rul me vibrim – 1 cope. Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikata e transportit të mallrave/Licencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistrin publikë duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)”.*

Referuar dokumentacionit të paraqitur me date 07.08.2023, konstatohet se për mjetin me targë AA664VY, i vetedeklaruar si automjet vetshkarkues me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton, është paraqitur certifikate transporti nr. 18, datë 05.07.2018, për mjetin me targë SR4591B, e cila nuk është e vlefshme, pasi edhe afati i vlefshmerisë ka përfunduar me 04.07.2023.

Gjithashtu, certifikata e kontrollit teknik e paraqitur per mjetin e sipercituar me targe AA664VY nuk eshte e vlefshme, pasi afati i vlefshmerise ka perfunduar me 04.07.2023.

4. Nuk permbush piken 2.3.g te Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Certifikate: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi*”, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur me date 07.08.2023, konstatohet data e skadences se certifikates me 05.08.2023.

5. Nuk permbush piken 2.3.h te Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Certifikate: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi referuar dokumentacionit te paraqitur me date 07.08.2023, konstatohet data e skadences se certifikates me 05.08.2023.

4- Për ofertuesin EURONDERTIMI 2000 me NIPT K02003001O, me vlerë të ofertës **16’294’277.00 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **EURONDERTIMI 2000**:

1. Nuk permbush piken 2.3.h te Kapacitetit Teknik ku citohet “*Certifikate: ISO 45001:2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, pasi ne permbushje te ketij kriteri nuk ka paraqitur certifikaten perkatese.

5- Për ofertuesin LIQENI VII me NIPT K01730502W, me vlerë të ofertës **17’146’605.00 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **LIQENI VII**:

1. Nuk permbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik per disponimin punonjesve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjese e punonjesve dhe mjeteve/pajisjeve te vetedeklaruara per kete procedure prokurimi jane te angazhuar ne kontraten me objekt “Riforcimi pallateve me kod gis: 25759, 25583, 22842, 22243, 22248, 22866, 24812, 22707, 25248, 22721, 24821, 22245, 22299”

6-Për ofertuesin RSM COMPANY me NIPT L04803001U, me vlerë të ofertës **17’148’562.00 lekë**, me subjekt mbeshtetes DESARET COMPANY me NIPT K01816001J, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **RSM COMPANY**:

1. Nuk permbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f te Kapacitetit Teknik, pasi pjese e mjeteve dhe punonjesve te vetedeklaruar per kete procedure prokurimi nga subjekti RSM COMPANY jane te angazhuar ne kontraten me objekt “Ndertim kanali kuz ne rrugen Gjergj Balsha”.

7- Për ofertuesin BEQIRI me NIPT J98624801V, me vlerë të ofertës **17'685'709.70 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **BEQIRI**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.c, 2.3.d, 2.3.e, 2.3.f të Kapacitetit Teknik për disponimin punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve, pasi pjesë e punonjësve dhe mjeteve/pajisjeve të vetedeklaruara për këtë procedurë prokurimi janë të angazhuar në kontratën me objekt "Rikonstruksion rruga Currila segmenti Hotel Ferrara – Guest House".

8- Për ofertuesin ZEQILLARI me NIPT L61912024O, me vlerë të ofertës **18'265'741.82 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **ZEQILLARI**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.d të Kapacitetit Teknik për disponimin e stafit mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), pasi nuk ka vetedeklaruar inxhinier elektrik dhe hidroteknik në përmbushje të këtij kriteri.

2. Nuk përmbush piken 2.3.e të Kapacitetit Teknik për disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar, pasi në përmbushje të këtij kriteri ka vetedeklaruar 1 karpentier nga 2 të kërkuar.

9- Për ofertuesin SARK me NIPT K52531415H, me vlerë të ofertës **19'549'352.00 lekë**, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **SARK**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik ku citohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 10'000'000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 40'000'000 lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme*", pasi në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ndër të tjera ka paraqitur edhe punën e ngjashme me objekt Asfaltim i parkimit midis pallateve, Divjake, e cila nuk merret në konsideratë, pasi është jashtë afatit 5 vjeçar të kërkuar në DST.

Punët e ngjashme të tjera të paraqitura nuk plotësojnë vlerën minimale të kërkuar në piken a) dhe b) të pikës 2.3.a të Kapacitetit Teknik për punë të ngjashme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [K.M.K me NIPT L78223801E + CAUSHI M me NIPT L88419801O me adresë: Fier Ballsh BALLSH Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/Ndertese], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 15'633'895.00 (pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e

tridhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) / totali i pikëve të marra [____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Durrës, Njësia e Prokurimit, *njesia.prokurimeve@durres.gov.al*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [16'166'368,00], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Vendim: NR.391/2023 me NR. Prot datë 18.05.2023

Vendim: NR.1040/2023 me NR. Prot datë 16.10.2023.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Emiriana Sako